

Në bazë të nenit 55 alinea 1 të Ligjit për organizimin e punës së organeve të administratës shtetërore (“ Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 58/00, 44/02, 82/08, 167/10,51/11,96/19 dhe 110/19) dhe nenit 38 alinea 1 nga Ligjit për arsim të mesëm (“ Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr, 44/99, 24/96, 34/96, 35/97, 82/99, 29/02, 40/03, 42/03, 67/04,55/05, 98/15, 145/15, 30/16, 127/16, 67/17, 64/18 dhe Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 229/20), ministri për arsim dhe shkencë e solli programin e provimit për lëndën e historisë për maturë shtetërore në arsimin e mesëm gjimnazor dhe në arsimin e mesëm profesional.

PROGRAMI PËR PROVIM

MINISTRIA PËR ARSIM DHE SHKENCË
BIROJA PËR ZHVILLIMIN E ARSIMIT

HISTORI

MATURA SHKETËRORE

Shkup , 2022

Arsimi gjimnazor,
Arsimi i mesëm profesional

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
BIROJA PËR ZHVILLIMIN E ARSIMIT

PROGRAMI I PROVIMIT

HISTORI

**MATURA SHTETËRORE
NË ARSIMIN GJIMNAZOR DHE
NË ARSIMIN E MESËM PROFESIONAL**

Programi i provimit në lëndën histori për maturë shtetërore në arsimin gjimnazor, të mesëm dhe në arsimin artistik u soll me vendim të Ministrit për arsim dhe shkencë me nr. _____ në vitin _____

1. HYRJE

Në përputhje me ndryshimet konceptuale dhe përmbajtjesore në arsimin gjimnazor dhe arsimit profesional katërvjeçar, ndryshime janë bërë edhe në provimet në mbarim të arsimit të mesëm.

Vendosja e provimeve të centralizuara në mbarim të arsimit të mesëm është në funksion të kontrollit të cilësisë, e rrjedhimisht edhe i përmirësimit të mësimin në arsimin e mesëm. Zbatimi i modeleve të reja të provimeve në arsimin e mesëm imponoi nevojën për përgatitjen e programeve për provime.

Programi i provimit në lëndën histori për arsimin e mesëm (gjimnaz, profesional katërvjeçar) është dokumenti themelorë mbi të cilin bazohet provimi i maturës në këtë lëndë. Në këtë dokument përcaktohen qartë se cilat njohuri, aftësi dhe shkathtësi do të kontrollohen në provim.

Programi i provimit është i dedikuar kryesisht për nxënësit dhe mësimdhënësit, përpiluesit e materialeve të provimit, organizatorët e provimit, si dhe për përdoruesit tjerë. Si dokument zyrtar, programi i provimit është elementi më i rëndësishëm në sigurimin e transparencës në sistemin arsimor.

Programi i provimit përgatitet sipas programeve mësimore të historisë për arsimin gjimnazor - drejtimi shoqëror/humanist (ku historia përfaqësohet si lëndë e detyrueshme në vitet I, II dhe III me 2 orë fond javor dhe në vitin IV si lëndë zgjedhore me 2 orë të tjera në javë). Nxënësit e arsimit të mesëm profesional (ku historia mësohet si lëndë e detyrueshme në vitin I dhe II me 2 orë në javë) dhe nxënësit e arsimit gjimnazor në dy drejtimet e tjera: matematiko-natyrorë dhe gjuhë-artistik (ku historia mësohet si lëndë e detyrueshme në vitin I, II dhe III me 2 orë në javë) të cilët zgjedhin historinë për provimin e maturës do të duhet të bëjnë përpjekje shtesë për të përvetësuar përmbajtjet mësimore që nuk i kanë mësuar gjatë kohës së mësimin.

Programi i provimit përmban këto komponente:

- Qëllimi i përgjithshëm i provimi
- Përmbajtja e provimit
- Specifikimi i fushave dhe aftësitë
- Konkretizimi i qëllimeve
- Rrjeti specifikues i provimit
- Përshkrimi i provimit
- Mënyra e vlerësimi

2. QËLLIMI I PËRGJITHSHËM I PROVIMIT

Kalimi me sukses i provimit të maturës shtetërore, që përfshin lëndën e historisë, sipas Konceptit për maturën dhe provimin përfundimtar në arsimin e mesëm publik, do të thotë hyrje direkte në fakultete.

Me provimin e maturës në lëndën e historisë bëhet rrumbullaksimi, respektivisht bëhet vlerësimi përfundimtar i njohurive dhe aftësive të cilat nxënësit duhet ti arrijnë në përfundim të procesit arsimor katërvjeçar.

Qëllimi i përgjithshëm i provimit të maturës në histori është të kontrollojë nëse nxënësi:

- di dhe kupton një numër të caktuar faktesh historike, termash, ngjarjesh, dukurish, procesesh dhe personalitete nga koha e vjetër, mesjeta, koha e re dhe koha më e re;
- është në gjendje të analizojë, zbulojë dhe shpjegojë marrëdhëniet shkak- pasojë të dukurive dhe proceseve historike;
- është në gjendje të krahasojë disa dukuri, procese, personalitete, epoka dhe lokalitete historike;
- është në gjendje të interpretojë, argumentojë dhe të nxjerrë përfundime për dukuri dhe procese të ndryshme;
- di të dallojë normativen nga realja dhe deklarativen nga objektiviteti në dukuritë dhe proceset historike;
- është në gjendje të vlerësojë interpretime të caktuara historike, ngjarje dhe procese;

3. PËRMBAJTJA E PROVIMIT

3.1. Specifikimi i fushave (përmbajtjeve) dhe aftësive

Fushat e programit:

- Koha e vjetër
- Koha e mesme
- Koha e re
- Koha më e re

Për të kaluar provimin, nxënësi duhet:

- **(A1) DI DHE KUPTON** një numër të caktuar të fakteve, koncepteve, ngjarjeve, dukurive, proceseve dhe personaliteteve historike.
- **(A2) është i aftë të ANALIZË DHE ZBULOJ**, të shpjegojë marrëdhëniet shkak-pasojë të dukurive dhe proceseve historike, të bëjë krahasime midis disa fenomeneve, proceseve, personave, epokave dhe lokaliteteve historike, të interpretojë, të argumentojë dhe të nxjerrë përfundime për fenomene dhe procese të ndryshme;
- **(A3) është në gjendje të BËJË VLERËSIM** të disa interpretimeve, ngjarjeve dhe proceseve historike, të dallojë normativën nga realja dhe deklarativen nga objektiviteti.

3.2. Konkretizimi i qëllimeve (njohurive dhe aftësive) sipas fushave

FUSHA 1: KOHA E VJETËR	
Përmbajtja	Njohuritë dhe aftësitë
- Lindja e lashtë: Qytetërimet e para – Shteti i Egjiptit; Fenikia dhe Palestina; Arritjet kulturore të popujve të Lindjes së lashtë - Ballkani në kohën e vjetër Helada e vjetër – Sparta dhe Athina; Kultura e Heladës; ilirët dhe thrakasit - Maqedonia në kohën e vjetër Shteti i vjetër maqedonas deri në Filipin II; Shteti maqedonas në kohën e Filipit II; Shteti maqedonas në kohën e Aleksandrit III të Maqedonisë ; Periudha helene	Nxënësi duhet: - të bëjë një analizë të pavarur të teksteve historike dhe ilustrimeve historike; - të interpretojë dokumentet historike dhe të vlerësojë interpretimet e ndryshme; - të dijë për fillimet e qytetërimeve të hershme , - të kuptojë shkaqet kryesore të ngjarjeve historike, dukurive dhe proceseve dhe marrëdhënieve shkak-pasojë , zhvillimin dhe shkatërrimin e shteteve (civilizimeve) në Lindjen e Vjetër; - të identifikojë për kulturën kreto-mikenase, kulturën e periudhës homerike dhe kulturat e popujve të tjerë të Ballkanit ; - të shpjegojë dhe krahasojë karakteristikat e rregullimit të poliseve greke , Spartës dhe Athinës; - të vlerësojë rëndësinë e kulturës së Heladës ; - të kuptojë thelbin e demokracisë athinase dhe reformat e përfaqësuesve të saj më të rëndësishëm; - të shpjegojë procesin e krijimit të Mbretërive ilire - të dijë për procesin e krijimit të Mbretërisë thrakase - të dijë për specifikat dhe karakteristikat në krijimin e shtetit të vjetër maqedonas; - të analizojë ngritjen e shtetit maqedonas gjatë kohës së Filipit II dhe sundimit të tij me botën helene; - të shpjegojë rritjen e Maqedonisë në fuqi botërore dhe të vlerësojë personalitetin e Aleksandri III të Maqedonisë, vendin e tij në historinë botërore dhe përhapjen e kulturës helene.

- Roma e lashtë Krijimi dhe zgjerimi i shtetit romak; Rënia e shtetit romak dhe konfliktet e brendshme; Shfaqja dhe përhapja e krishterimit - Maqedonia nën sundimin romak Maqedonia nën sundimin romak; Përhapja e krishterimit në Maqedoni	- të dijë për krijimin e Shtetit romak dhe për teoritë lidhur me formimin e Romës; - të paraqesë në mënyrë grafike organizimin shtetëror dhe shoqëror të Shtetit romak dhe zhvillimin e tij (mbretëria, republika mbretëria); - të njohë shkaqet e rënies së Perandorisë romake; - të shpjegojë fillimet dhe përhapjen e krishterimit; - të analizojë qëndrimin e shtetit ndaj krishterimit dhe shpalljen e krishterimit si religjion shtetëror. - të shpjegojë shkaqet dhe rrjedhën e luftërave maqedono-romake; - të dijë për fillimin e përhapjes së krishterimit në Maqedoni, për formimin e komunave të krishtera dhe rolin e apostull Palit.
--	--

FUSHA 2: MESJETA	
Përmbajtja	Njohuritë dhe aftësitë
- Bota dhe Evropa në mesjetën e hershme Dyndja e madhe e popujve; Shteti i frankëve; Arabët dhe shfaqja e Islamit; Perandoria Romake Lindore (Bizanti)	Nxënësi duhet: - ti njohë shkaqet, rrjedhën dhe pasojat nga dyndja e madhe e popujve; - të shpjegojë krijimin e shtetit të frankëve, zhvillimin dhe rënien e tij; - të përshkruar shfaqjen e Islamit, rolin e Muhamedit a.s. - të dijë për zhvillimin e Bizantit dhe marrëdhëniet e tij me fiset barbare; - të interpretojë procesin e shpërbërjes së kishës krishtere; - të vlerësojë karakteristikat kryesore të kulturës bizantine.
- Ballkani në mesjetën e hershme Sllavët dhe shpërngulja e tyre në Ballkan	- të përshkruajë territorin, mënyrën e jetesës, zakonet dhe drejtimit e shpërnguljes së sllavëve; - të analizojë ndryshimet që ndodhën në Ballkan me depërtimin e fiseve sllave.
- Maqedonia në mesjetën e hershme Shpërngulja e sllavëve në Maqedoni; Shfaqja dhe zhvillimi i shkrim-leximit dhe kulturës sllave; Veprimtaria e Sh. Klementi dhe Sh. Naumit në Maqedoni; Krijimi i shtetit maqedonas – Mbretëria e Samoilit; Organizimi i Shtetit të Samoilit; Dobësimi dhe rënia e shtetit të Samoilit; Kryepeshkopata e Ohrit; Kryengritjet në Maqedoni në shekullin XI-të.	- të analizojë procesin e vendosjes së sllavëve në Maqedoni, procesin e simbiozës me vendasit dhe rënien e tyre nën sundimin bizantin; - të vlerësojë shfaqjen dhe rëndësinë e shkrim-leximit dhe kulturës sllave dhe veprës së Shën Kirilit, Shën Metodi, Shën Klimentit dhe Shën Naumit; - të shpjegojë krijimin e Shtetit të Samoilit, rregullimin e brendshëm të tij, ngritjen dhe rënien e tij; - të shpjegojë procesin e krijimit dhe mbijetesës së Kryepeshkopatës së Ohrit (si ishte organizimi i brendshëm kishtar i Kryepeshkopatës së Ohrit, cili ishte roli i kishës krishtere në historinë mesjetare të popullit maqedonas); - të dinë për kryengritjet e Pjetër Delijanit dhe të Gjorgji Vojtehut.
- Bota dhe Evropa në Mesjetën e zhvilluar dhe të vonë deri në fund të shekullit të XVIII -Humanizmi dhe Renesansa ; Zbulimet e mëdha gjeografike	- të analizojë karakteristikat e humanizmit dhe të renesansës dhe të njohë përfaqësuesit më të rëndësishëm të asaj epoke; - të shpjegojë arsyet dhe rrethanat në të cilat u bënë e zbulime e mëdha gjeografike;

- Maqedonia në mesjetën e zhvilluar Rënia e Maqedonisë nën sundimin osman - Ballkani dhe Maqedonia nën sundimin osman nga shekulli XV deri në shekullin XVIII Organizimi i Shtetit osman dhe krijimi i sistemit timaro-spahi; Rezistenca kundër sundimit osman; Kryengritja e Gjergj Kastriot-Skenderbeut; Kryengritja e Karposhit; Kryepeshkopata e Ohrit	- të përshkruajë kushtet dhe mënyrën se si Maqedonia ra nën sundimin e pushtetit osman. - të shpjegojë karakteristikat themelore të sistemit timaro-spahij; - të interpretojë ndryshimet ekonomike, etnike dhe fetare që ishin rezultat i pushtimeve osmane; - të njohë mënyrën e kolonizimit dhe islamizimit të vendeve ballkanike; - të njohë llojet e rezistencës kundër pushtetit osman; - të shpjegojë kryengritjen e Gjergj Kastriot-Skenderbeut dhe pasojat e shtypjes së kryengritjes; - të shpjegojë luftën austro-osmane dhe pjesëmarrjen e popujve ballkanike në luftë; - të shpjegojë shkaqet, rrjedhën dhe pasojat e kryengritje së Karposhit; - të analizojë qëndrimin e qeverisë osmane ndaj Kryepeshkopatës së Ohrit dhe shkaqet për heqjen e saj; - të vlerësojë vendin e Kryepeshkopatës së Ohrit për ruajtjen e fesë dhe kulturës së krishterë në Maqedoni dhe më gjerë.
--	---

FUSHA 3: KOHA E RE

Përmbajtja	Njohuritë dhe aftësitë
- Bota dhe Evropa nga fundi i shekullit të 18-të deri në Luftën e Parë Botërore Revolucioni francez dhe gjendja në Evropë në gjysmën e parë të shekullit të XIX-të; Krijimi dhe ngritja e Shteteve të Bashkuara të Amerikës; Evropa në gjysmën e dytë të shekullit të XIX dhe në fillim të shekullit të XX; Rusia deri në Luftën e Parë Botërore - Ballkani nga fundi i shekullit XVIII deri në Luftën e Parë Botërore Shteti osman në shekullin XIX dhe fillimin e shekullit të XIX; Luftërat Ballkanike; Shqipëria në shekullin XIX deri në fillimin e Luftës së Parë Botërore - Maqedonia nga fundi i shekullit XVIII deri në Luftën e Parë Botërore Kryengritja e Razllovcit; Kryengritja maqedonase (Kryengritja e Kresnjës); Maqedonia në politikën e Fuqive të mëdha dhe të shteteve ballkanike në gjysmën e dytë të shekullit XIX; Propaganda e jashtme në Maqedoni dhe lufta për ripërtirjen e Kryepeshkopatës së Ohrit; ORM (Organizata Revolucionare Maqedonase) 1893-1903; * Veprimtarët e shquar të ORM-së; ORM dhe marrëdhëniet me Komitetin e Brendshëm Maqedonas (KBM) ; * Kryengritja e Ilindenit; Maqedonia gjatë kohës së Hyrijetit (1908-1912); Maqedonia në luftërat ballkanike	Nxënësi duhet: - të analizojë shkaqet dhe pasojat e Revolucionit francez; - të interpretojë Deklaratën e të drejtave të njeriut dhe qytetarit; - të dijë për formimin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe rritjen e SHBA-ve në fuqi botërore; - të analizojë dukuritë dhe proceset në Evropë në gjysmën e dytë të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX; - të shpjegojë Krizën e madhe lindore dhe rolin e Fuqive të Mëdha (gjendja në Rusi dhe politika e saj ballkanike deri në Luftën e Parë Botërore). - Të njohë shkaqet që ndikuan në dobësimin e Perandorisë osmane; - të analizojë ndikimet që çuan në zgjimin kombëtar te popujt ballkanikë në Perandorinë osmane; - të përshkruajë gjendjen e Shqipërisë në shekullin XIX dhe në fillim të shekullit XX. - Të shpjegojë shkaqet, rrjedhën dhe pasojat e Kryengritjes së Razllovcit dhe Kresnjës; - të analizojë gjendjen e brendshme dhe pozitën ndërkombëtare të Maqedonisë gjatë Krizës Lindore; - të përshkruajë përpjekjet për organizimin e veprimtarisë kishtare-shkollore dhe luftën për ripërtirjen e Kryepeshkopatës së Ohrit; - të analizojë mënyrat, qëllimet dhe pasojat e veprimit të propagandave të huaja në Maqedoni; - të dijë për themelimin e ORM-së dhe zhvillimin e saj deri në Kryengritjen e Ilindenit, - të shpjegojë rëndësinë e veprimtarëve të shquar të ORM-së, të analizojë marrëdhëniet e ORM-së me KBM-së; - të shpjegojë vendimet për fillimin e Kryengritjes së Ilindenit; - të dijë për fillimin dhe rrjedhën e kryengritjes, krijimin e Republikës së Krushevës; - të interpretojë Manifestin e Krushevës, - të analizojë pasojat për popullin maqedonas nga Kryengritja e Ilindenit, ndryshimet dhe gjendjen në Maqedoni gjatë kohës së Hyrijetit dhe pjesëmarrjen e maqedonasve në jetën politike gjatë sundimit të Turqëve të rinj;

Shqiptarët nga fundi i shekullit XVIII deri në Luftën e Parë Botërore - Lëvizja kombëtare e shqiptarëve për krijimin e një shteti të pavarur; Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë	- të dijë për pasojat e luftërave ballkanike për Maqedoninë dhe popullin maqedonas - të shpjegojë lëvizjen politike e kulturore-arsimore të shqiptarëve, lëvizjet e tyre kryengritëse (1910; 1911 dhe 1912) dhe rëndësinë e Kongresit të Manastirit, Kongresit në Elbasan dhe në Dibër; - analizojë rrethanat e shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë; - të dijë për raportet dhe qëndrimet e faktorëve ndërkombëtarë ndaj Shqipërisë;
--	---

FUSHA 4: KOHA MË E RE

përmbajtja	Njohuritë dhe aftësitë
- Bota, Evropa dhe Ballkani në Luftën e Parë Botërore Evropa në fillim të shekullit XX; Lufta e Parë Botërore; Revolucioni në Rusi dhe reflektimi i tij në Evropë; Popujt dhe shtetet ballkanike në Luftën e Parë Botërore; Konferenca e Paqes në Paris	Nxënësi duhet: - të krahasojë dhe sintetizojnë dukuri, procese dhe personalitete me grafikone të ndryshme; - të krahasojë dukuri të ndryshme, të kërkojë lidhje ndërmjet tyre (ngjashmëritë dhe dallimet); - të interpretojë proceset e kaluara në kontekstin e pasojave bashkëkohore përmes analizës së dokumenteve, karikaturave dhe burimeve të tjera historike, teksteve dhe ilustrimeve për botën, Evropën, Ballkanin dhe Maqedoninë në periudhën e viteve 1914-1919 ; - të shpjegojë industrializimin, zhvillimin e demokracisë qytetare; - të analizojë karakteristikat themelore dhe interesat e veçanta të shteteve të mëdha në fillim të shekullit XX; - të dallojë shkaqet nga shkasi për Luftën e Parë Botërore; - të dijë për qëllimet e të dyja palëve në luftë, momente më të rëndësishme të luftës dhe pasojat e saj; - të përshkruajë gjendjen në Rusi gjatë Luftës së Parë Botërore, shpërthimi Revolucionit të Tetorit; krijimin e BRSS dhe ndikimin e Revolucionit të Tetorit në Botë - të shpjegon hyrjen e shteteve ballkanike në Luftën e Parë Botërore dhe pozitën e popullsisë së tyre gjatë kohës së luftës; - të sqarojë për Frontin maqedonas; të shpjegon pasojat e luftës për vendet dhe popujt ballkanikë; - të dijë për vendimet më të rëndësishme të Konferencës së Paqes në Paris dhe të vlerësojë karakterin e hartës së re politike të Evropës.
- Maqedonia në Luftën e Parë Botërore * Maqedonia dhe populli maqedonas në Luftën e Parë Botërore	- Të shpjegon pozitën e Maqedonisë në negociatat mes Antantës dhe Forcave të Boshtit; - të përshkruajë pozitën e popullit maqedonas nën pushtim dhe mobilizimin e maqedonasve në ushtritë e huaja.

Shqipëria dhe shqiptarët në Luftën e Parë Botërore Shqiptarët në Luftën e Parë Botërore; Pozicioni i shqiptarëve në marrëveshjet ndërkombëtare; Shqipëria dhe shqiptarët në periudhën 1919-1939; - Bota dhe Evropa mes dy luftërave botërore Marrëdhëniet ndërkombëtare ndërmjet dy luftërave botërore; Shfaqja e fashizmit dhe kriza e demokracisë civile - Shtetet ballkanike ndërmjet dy luftërave botërore Marrëdhëniet ndërmjet shteteve ballkanike ndërmjet dy luftërave botërore - Maqedonia mes dy luftërave botërore Maqedonia nën sundimin e vendeve fqinje ; Lëvizja nacionalçlirimtare maqedonase ndërmjet dy luftërave botërore; Afërimi i vetëdijes, gjuhës dhe kulturës kombëtare maqedonase - Bota në Luftën e Dytë Botërore Lufta e Dytë Botërore 1939-1941; Lufta e Dytë Botërore 1941-1943; Lufta e Dytë Botërore 1943-1945	- Të shpjegojë pozicionin e Shqipërisë dhe të shqiptarëve gjatë Luftës së Parë Botërore; - të interpretojë pozitën e Shqipërisë në marrëveshjet ndërkombëtare gjatë kohës së luftës dhe pas saj dmth në Konferencën e Fshehtë të Londrës (1915) dhe në Konferencën e Paqes në Paris (1919); - të dijë për ngjarjet kryesore në jetën politike të Shqipërisë në periudhën 1919-1939. - të dijë për marrëdhëniet politike në Evropë dhe në botë pas Luftës së Parë Botërore dhe përpjekjet për të krijuar një sistem të sigurisë kolektive në Evropë; - të shpjegojë krizën e madhe ekonomike dhe orvatjet e ndryshme të daljes prej saj. - të analizojë qëndrimin e fuqive të mëdha ndaj popujve dhe shteteve ballkanike në Konferencën e Paqes në Paris; - të shpjegojë jetën politike në shtetet ballkanike dhe pozitën e minoriteteve në shtetet ballkanike ndërmjet dy luftërave botërore; - të krahasojë pozitën e popullit maqedonas nën sundimin e regjimeve të ndryshme ballkanike; - të analizojë politikat shkombëtarizuese dhe asimiluese, dhe ndryshimet etnike; - të dijë për organizimet dhe rrymat e ndryshme në lëvizjen nacionalçlirimtare maqedonase ndërmjet dy luftërave botërore; - të shpjegon përpjekjet e organizatave maqedonase, të shoqërive dhe veprimtrëve për afirmimin e vetëdijes kombëtare maqedonase, të gjuhës dhe të kulturës maqedonase. - Të dijë shkaqet e Luftës së Dytë Botërore, shkaku për fillimin e saj, rrjedhën e luftës dhe betejat më të rëndësishme të cilat shënuan kthesat më të rëndësishme në periudhën prej vitit 1939 deri në vitin 1945; - të shpjegon marrëveshjet më të rëndësishme ndërshtetërore në periudhën prej vitit 1939 deri në vitin 1945; të përshkruajë kapitullimin e Aleancës së Trefishtë; - të analizojë pasojat e Luftës së Dytë Botërore.
--	---

- Maqedonia në Luftën e Dytë Botërore Pushtimi fashist dhe ndarja e Maqedonisë; LNÇ dhe lufta antifashiste e popullit maqedonas në pjesën e Vardarit të Maqedonisë 1941-1944; Konstituimi i shtetit maqedonas; Lëvizja nacionalçlirimtare dhe LNÇ në pjesën Pirinit dhe të Egjeut të Maqedonisë në Luftën e Dytë Botërore - Bota pas Luftës së Dytë Botërore Holokausti; Politika në krijimin e botës së pasluftës; Marrëdhëniet ndërkombëtare social-ekonomike dhe politike në botë pas Luftës së Dytë Botërore; Tendencat e reja dhe ndryshimet në botë; Shqipëria dhe shqiptarët në Luftën e Dytë Botërore dhe në periudhën e pasluftës Shqiptarët nën pushtimin fashist; Lufta nacionalçlirimtare në Shqipëri 1939-1944; Shqipëria dhe shqiptarët pas Luftës së Dytë Botërore; Pozita politike dhe kulturore-arsimore e shqiptarëve në RSFJ 1974-2000; Shqipëria dhe shqiptarët në periudhën e futjes së pluralizmit	- të përshkruajë pushtimin dhe ndarjen e Maqedonisë; - të analizojë përgatitjet për luftën e armatosur antifashiste dhe rrjedhën e LNÇ në pjesën e Vardarit të Maqedonisë; - të dijë për zhvillimin e forcës ushtarake dhe organizimin e pushtetit popullor deri në konstituimin e shtetit modern maqedonas në seancën e parë të KAÇKM; - të shpjegojë lëvizjen nacionalçlirimtare në viset Pirin dhe Egje të Maqedonisë dhe bashkëpunimin me lëvizjen çlirimtare në pjesën e vardariane të Maqedonisë; - të analizojë pozicionin e Maqedonisë në periudhën e formimit të federatës jugosllave. - Të shpjegojë holokaustin; - të dijë vendimet më të rëndësishme të Konferencës së Potsdamit; - të analizojë vendimet e Konferencës së Paqes në Paris dhe pasojat e tyre për botën e pasluftës; - të shpjegojë formimin e OKB-së dhe mekanizmat e saj për ruajtjen e botës paqe; - të analizojë arsyet e shfaqjes së Luftës së Ftohtë dhe të formimit të blloqeve (NATO dhe Pakti i Varshavës); - të përshkruajë zbatimin e Planit Marshal dhe Doktrinën e Trumanit; - të dijë për integrimet evropiane dhe për asociacionet më të rëndësishmet evropiane. - Të dijë për pozitën e shqiptarëve dhe Shqipërisë në kohën epushtimit fashist; - të shpjegojë për pjesëmarrjen e shqiptarëve në LNÇ-në antifashiste në Jugosllavi dhe Shqipëri; - të analizojë jetën politike dhe kulturore në Shqipëri gjatë kohës së regjimit komunist;
---	---

- Maqedonia pas Luftës së Dytë Botërore Zhvillimi socio-politik dhe ekonomik i Maqedonisë 1946-1991; Krijimi i Maqedonisë si shtet i pavarur dhe sovran; Kisha Ortodokse Maqedonase dhe bashkësitë tjera fetare në Maqedoni; Arsimi, shkenca dhe kultura; Pozita e maqedonasve në vendet fqinje;	- Të analizohet pozita e Maqedonisë në kuadrin federatës jugosllave; - të përshkruajë proceset, dukuritë dhe ndryshimet në sferën politike dhe ekonomike në Republikën e Maqedonisë nga viti 1945 deri në vitin 1991; - të shpjegojë procesin e pavarësisë së RM dhe zhvillimin e saj deri në vitin 2000; - të njohë pozitën e maqedonasve në vendet fqinje dhe të njohë pozitën e bashkësive etnike në RM.
---	--

4. RRJETI I SPECIFIKIMIT TË PROVIMIT

Rrjeti i specifikimit përcakton raportin e fushave (përmbajtjeve) dhe aftësive (qëllimet globale të provimit) të shprehur në përqindje.

Aftësitë	FUSHAT				
	F ₁	F ₂	F ₃	F ₄	PËRFAQËSIMI (%)
A ₁					45 – 55
A ₂					25 – 35
A ₃					15 – 25
PËRFAQËSIMI (%)	15 – 25	25 – 35	15 – 25	25 – 35	100

A₁ - njohuri dhe të kuptuarit

A₂ – analizë dhe zbulim

A₃ – vlerësim

F₁ – Koha e Vjetër

F₂ – Koha e mesme- mesjeta

F₃ – Koha e re

F₄ – Koha e Vjetër

5. PËRSHKRIM I PROVIMIT

Provimi intern për lëndën e historisë në kuadër të provimit të maturës shtetërore realizohet përmes testimit repektivisht zgjidhjes së testit.

Kohëzgjatja e provimit të historisë është 150 minuta.

Në testim janë të përfaqsuara tre lloje të detyrave për kontrollim:

- detyra në të cilat nxënësi duhet të zgjedhë një përgjigje të saktë nga disa përgjigje të ofruara;
- detyra në të cilat nxënësi duhet të shkruajë një përgjigje të shkurtër në vendin e caktuar;
- detyra në të cilat nxënësi duhet të analizojë, sistemojë ose të zgjidhë probleme në fushën e historisë.

Provimi intern i historisë realizohet në shkollë dhe me shkrim.

6. METODA E VLERËSIMIT

Numri maksimal i pikëve që mund të merren në provimin e historisë është 60 deri në 80.

Vlerësimi i provimit intern në lëndën e historisë, në kuadër të provimit të maturës shtetërore, bëhet nga Komisioni i maturës shkollore për lëndën e historisë në bazë të udhëzimit dhe të kriterëve të parapërgatitura.

Numrin minimal të pikëve për të kaluar provimin intern në lëndën e historisë, si dhe përcaktimin e numrit të pikëve për secilën nga notat pozitive (mjaftueshëm - 2, mirë - 3, shumë mirë - 4 dhe shkëlqyer - 5) e cakton Komisioni i maturës shkollore për lëndën e historisë.